



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 225/3 prot.

Tiranë, më 13.09.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2125/1, DATË 25.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETËSJA ZNJ. ALMA SYZIU, PËRFAQËSUAR NGA AV. SERXHIO AVDYLI DHE AV. MIRION THEODHOSI"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e znj. Alma Syziu me nr. 999 prot, datë 17.02.2021, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistrates E.B (V)., gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm, Tiranë dhe me vendimin nr. 2125/1, datë 25.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi znj. Alma Syziu", bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "c", nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesja: Blv: "Gjergj Fishta", kulla 3, zyra 9, Tiranë;
 - në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.
- Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

